



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E MENAXHIMIT TË GARANCIVE DHE KREDIVE TË PAKTHYERA
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I FINANCËS DHE BUXHETIT**

Nr 296/1 Prot.

Tiranë, më 17 / 02 / 2026

Lënda: Mbi raportin e monitorimit për 12 mujorin e vitit 2025.

**MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR**
Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.3
Tiranë

Bazuar në ligjin nr.55/2023 "Për Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera", ligjit nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2025", udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore", si dhe shkresës të dërguar "Mbi raportin e monitorimit të 12-mujorit 2025" datë 04.02.2026, është kryer monitorimi i zbatimit të buxhetit për Agjencinë e Menaxhimit të Garancisë dhe Kredive të Pakthyera për 12- mujorin e vitit 2025.

1. Hyrje

Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera, (AMGKP), është person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrit përgjegjës për financat, i krijuar sipas Ligjit nr. 55/2023, "Për Agjencinë e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera", i cili ka hyrë në fuqi në datën 01.01.2024.

Monitorimi i zbatimit të buxhetit për 12-mujorin e vitit 2025 për AMGKP-në përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të

treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Strukturat e AMGKP-së kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë me qëllim ndjekjen e objektivave të synuar. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi, evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të institucionit në krahasim me planin e miratuar. Analiza e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor i mundëson institucionit orientim dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Ky raport do të shërbejë si një pasqyrë e rëndësishme përmes së cilës institucioni do të synojë lidhjen e kostove buxhetore me produktet e performancës, si forma më e mirë e buxhetimit dhe vlerësimit financiar të ecurisë të institucionit.

2. Informacioni buxhetor

Në vijim paraqiten, në mënyrë të përmblëdhur, treguesit e realizimit të fondeve buxhetore për këtë periudhë, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar. AMGKP ka një produkt me emërtim “Kontrata të garancive dhe Kredive të Pakthyer”.

Tabela 1: Raporti përmblëdhës i shpenzimeve

Në lekë

Emërtimi	Buxheti vjetor 2025	Buxheti 12-mujor (Plani)	Realizimi vjetor	Realizimi në %
Shpenzime Korente	94,855,000	56,250,546	55,167,033	98.07%
Shpenzime Kapitale	0	0	0	0
Totali	94,855,000	56,250,546	55,167,033	98.07%

Fondet buxhetore të miratuara në fillim të vitit 2025, në shpenzime korente dhe shpenzime kapitale, në total janë 94,855,000 lekë, të cilat janë rishikuar gjatë vitit nëpërmjet shtesave dhe pakësimeve të shpenzimeve korente, me aktet normative nr. 6, datë 11.06.2025, dhe nr. 11 datë 19.12.2025. Vlera totale e buxhetit arriti, në fund të vitit 2025, në 56,250,546 lekë. Performanca e realizimit të fondeve buxhetore për vitin 2025 është 55,167,033 lekë, në nivelin 98.07%. Në një vështrim të përgjithshëm, buxheti total i miratuar për vitin 2025 ishte i mjaftueshëm për mbulimin e nevojave për shpenzimet korente. Buxheti për shpenzimet kapitale kanë qënë 0 lekë.

Në mënyrë analitike, performanca e realizimit të shpenzimeve për këtë periudhë, për AMGKP-në, paraqitet si në vijim:

Tabela 2: Realizimi i buxhetit sipas artikujve ekonomikë*Në lekë*

Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Realizimi vjetor	Realizimi në %
600+601	Paga dhe Sigurime	74,855,000	42,525,000	42,478,987	99.89
602+606	Shpenzime për mallra dhe shërbime dhe fond i veçantë	20,000,000	13,725,546	12,688,046	92.24
231	Shpenzime kapitale	0	0	0	-
	TOTALI	94,855,000	56,250,546	55,167,033	98.80

Artikulli 600 dhe 601, “Shpenzime personeli”, buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit 2025 për këtë zë është 74,855,000 lekë, buxhet i cili do të mbulojë nevojat e institucionit në fushën e pagave për të gjithë vitin, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Me shkresën nr.9326/59 prot., datë 09.07.2025 në zbatim të aktit normativ është pakësuar zëri 600+601 në vlerën 24,200,000 lekë.

Me shkresën nr.14505/99 prot., date 5.11.2025 në zbatim të aktit normativ është pakësuar zëri 600+601 në vlerën 8,320,000 lekë

Buxheti i rishikuar për zërin 600+601 pas rialokimeve është në vlerën 42,525,000 lekë. Performanca e realizimit të tij për vitin 2025, siç është paraqitur në formën tabelare, është në nivelin 99.89 %.

Për sa i përket numrit të punonjësve me urdhërin nr. 17 datë 25.01.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer”, numri i punonjësve të AMGKP-së është gjithësej 30 veta në strukturë. Gjithashtu me VKM nr.19, datë 09.01.2025 “Për përcaktimin e numrit të punojësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2025, në njësitë e qeverisjes qendrore” për institucionin tonë janë miratuar 4 punonjës me kontratë 6 orë. Mesatarja e plan/faktit për numrin e punonjësve janë 30 persona nga 34 persona gjithsej.

Artikulli 602 dhe 606, “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera dhe fondi i veçantë”, buxheti i miratuar në fillim të vitit në këtë artikull për vitin 2025, është 20,000,000 lekë. Pas rialokimit të fondeve nga shkresat e cituara më sipër, bashkë me të gjitha ndryshimet e kryera gjatë vitit dhe të miratuara nga ministria, buxheti vjetor i rishikuar ka shkuar në vlerën 13,725,546 lekë.

Performanca e realizimit të buxhetit të artikullit: “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera si dhe fondit të veçantë” për vitin 2025, është në nivelin 92.24 %.

Gjatë vitit 2025 janë kryer disa procedura prokurimi, blerje me vlerë të vogël, për blerje kancelari+tonera, blerje material pastrimi, shërbim riparim dhe mirmbajtje automjesh,

sigurim i objekteve dhe pajisjeve, shërbim mirëmbajtje pajisje elektronike dhe të zyrave, shpenzime vaj, filtra, alkol frenash për makinat, pajisje të automjeteve “Hyundai Accent” me targë AA 516 TF, AA 517 TF dhe “Hyundai Accent” me targë TR 9941F (Siguracion TPL). Ndërkohe që nga lista e Regjistrimit të Parashkimeve të Procedurave Publike për vitin 2025, nuk është realizuar zëri:

-Blerje karburanti, pasi nga verifikimet ka pasur gjendje mjaftueshëm për vitin 2025. Kjo blerje do të kryhet gjatë vitit 2026.

Në përfundim vlerësojmë se nga AMGKP, buxheti i vitit 2025 është zbatuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe konform fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2025, duke arritur një performancë të kënaqshme të realizimit të tyre, në të gjitha zërat e shpenzimeve, si dhe plotësimin e nevojave të domosdoshme për ecurin e aktivitetit institucional.

Shpenzime e artikullit 602 dhe 606 të detajuara si më poshtë vijon:

Në lekë

Artikulli 602+606	Realizimi 12 mujor
Blerje kancelari	195,861
Blerje materiale pastrimi	114,600
Shpenzime shërbime postare	165,445
Shpenzime energji elektrike	459,643
Shpenzime telefoni fiks	36,000
Shpenzime ujë	36,852
Shpenzime të tjera (Permbarim,ASHK, Mirëmbajtje krediti)	5,248,451
Shpenzime tatim taksa të paguara nga institucioni	21,612
Shpenzime gjyqesore	607,875
Shpenzime qiraje	3,360,000
Shpenzime transporti (taksa, kualidim)	174,030
Shpenzime Dieta	826,320
Shpenzime të sigurimit dhe ruajtjes	276,940
Shpenzime siguracion makine	64,097
Shpenzime mirëmbajtje të pajisjeve të zyrave	577,440
Shpenzime mirëmbajtje të mjeteve të transportit	474,880
Shpenzime kompesim telefoni	48,000
TOTAL	12,688,046

Arkëtimet nga debitorët

Agjencia e Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyera një ndër objektivat e saj ka dhe mbledhjen e kredive të ish bankave të nivelit të dytë me kapital shtetëror dhe investimet në banesa nga INSIG sh.a.

Sipas shkresës nr 23022/1 prot. datë 14.02.2024 mbi operimin e llogarive bankare të arkëtimit të detyrimeve të huamarrësit llogaritë ekzistuese në monedhat lekë, euro, usd në emër të kësaj agjencie do të operojnë sipas praktikës të deritanishme për arkëtimet e debitorëve të krijuar para datës 31.12.2023.

Referuar ligjit nr.55/2023, Kreut II, neni 3, pika 2 e ligjit citon “Të ardhurat e përfituara sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 4 dhe nenit 15 të këtij ligji derdhen në buxhetin e shtetit. Të gjitha arkëtimet e debitorëve nga llogaritë bankare të AMGKP bëhen derdhje cdo fund muaji në buxhetin e shtetit për KFW-në. Në fund të vitit rezultojnë të jenë mbajtur vetëm komisionet mujore për mirëmbajtjen e llogarive dhe komisionet e transfertave drejt TSA për çdo llogari në shumën 34,909.49 të konvertuara në lekë sipas kursit të Bankës të Shqipërisë.

Plani për mbledhjen e arkëtimeve për vitin 2025 për debitorët e transferuar nga ish-bankat me kapital shtetëror dhe Insig është vendosur në shumën 60,000,000 lekë. Gjatë vitit 2025 janë arkëtuar nga debitorët për detyrime dhe pagesa të tjera vërtetimesh 16,345,738.15 lekë, 1,450.00 Euro dhe 1,002.50 Usd të cilat janë konvertuar në lekë sipas kursit të Bankës të Shqipërisë në ditën që janë bërë arkëtimet.

Performanca e realizimit të planit të arkëtimeve është 27.63 %, referuar tabelës më poshtë.

Arkëtimet sipas monedhave për vitin 2025

Në lekë

Monedha	Arkëtimet sipas monedhave	Arkëtimet të konvertuara në lekë sipas K.K të BSH në ditën e arkëtimit
ALL	16,345,738.15	16,345,738.15
EUR	1450	140.084.5
USD	1002.50	95.979.35
Totali		16.581.802

Progresiv Janar –Dhjetor 2025

Plan	Fakt	%
60,000,000 All	16,581,802 All	27.63

3. Performanca jo-financiare e programit buxhetor

Misioni i AMGKP-së është: *Sigurimin e menaxhimit të skemave të veçanta të garancive të huasë dhe trajtimin e kredive të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror pas privatizimit të tyre, në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr.55/2023, “Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera”.*

Përshkrimi i Produktit: *“Mbledhja e detyrimeve të huamarrësve kundrejt Ministrisë së Financave si rezultat i pagesës së garancive dhe detyrimeve të Ish bankave me kapital shtetëror”.*

Qëllimi Politikës së Programit: *“Menaxhimin e skemave të veçanta të Garancive të huasë, mbledhjen e detyrimeve të kredive të transferuara nga bankat tregtare të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror pas privatizimit të tyre”.*

Objektivat e Agjencisë:

- Mbledh detyrimet e huamarrësve kundrejt ministrisë përgjegjëse për financat për detyrimet që kanë lindur si rezultat i pagesës së garancive nga ministria përgjegjëse për financat dhe si rezultat i marrëdhënies së huadhënies e nënhuazimit të fondeve;
- Verifikon dhe konfirmon përmbushjen e kërkesave të marrëveshjeve të garancisë në tipat e kontratave bankare;
- Administron informacionin dhe dokumentacionin e skemave të veçanta të garancisë;
- Monitoron shlyerjen e detyrimeve të huamarrësve ndaj ministrisë përgjegjëse për financat për pagesat e kryera nga kjo e fundit, në kuadër të marrëveshjeve të garancisë;
- Kryen mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marrë garanci nga skemat që ajo menaxhon dhe u kërkon huamarrësve informacionin e nevojshëm për realizimin e kësaj mbikëqyrjeje.
- Mban, menaxhon dhe përditëson bazën e të dhënave dhe regjistrin analitik të garancive që menaxhon

Tregues i performancës i projektuar për të matur rezultatin e lidhur me objektivat janë:

1. *“Numri i debitorëve të trajtuar duke ezauruar rrugën gjyqësore dhe përmbarimore deri në likuidimin total të detyrimeve”*
2. *“Numri i kredive të mbyllura në raport me numrin e kredive në trajtim”.*
3. *“Numri i çështjeve të trajtuara për thirrjen e Garancisë si dhe trajtimi i nënhuave”.*
4. *“Përqindja e uljes të portofolit në trajtim”*

Detyrat e realizuara sipas sektorëve përkatës.

• Sektori i Ndjekjes së Procedurave Juridike dhe Operacionale

Sipas raportimit nga Sektori i Ndjekjes së Procedurave Juridike dhe Operacionale gjatë 12 mujorit të vitit 2025 ka patur në fokus:

1. Zgjidhjen me sukses të kërkesave dhe problematikave të debitorëve;
2. Trajtimin ligjor të dosjeve;
3. Arkëtimet nga debitorët të cilat derdhen në buxhetin e shtetit.

Për muajin Janar-Dhjetor janë bërë 64 kërkesa për mbyllje nga debitorët e ish bankave të Nivelit të dytë me kapital shtetëror dhe plani është realizuar në masën 100 % ku janë mbyllur me vendim drejtorie 64 debitorë.

Për vitin 2025, janë hasur disa problematika, disa nga të cilat janë të evidentuara si më poshtë:

- Pavlefshmëria e titujve ekzekutivë.
- Amortizimi i borxhit
- Adresat jo të sakta
- Mosha e debitorëve
- Kushtet e vështira social-ekonomike të debitorëve
- Mungesa e dokumentacionit tekniko-ligjor të pasurive në pronësi të AMGKP-së
- Mungesa e regjistrimit në QKB
- Mungesa e të dhënave të debitorëve.
- Numri në rritje i procesve gjyqësore

E megjithatë, pavarësisht vështirësive të krijuara për pjesën më të madhe të vitit ka vijuar puna nga i gjithë stafi i AMGKP-së me qëllim realizimin e detyrave dhe realizimin e arkëtimeve sipas planifikimit. Me gjithë vështirësitë u arrit që të arkëtohen vetëm 27.63 % e planit vjetor.

Treguesit e arkëtimeve dhe performances të Sektorit

Stafi është orientuar edhe për një vëmendje të posaçme kushtuar etapave të trajtimit ligjor të huamarrësve.

1. Gjatë Vitit 2025 janë ekzekutuar 64 dosje të debitorëve të AMGKP-së
2. Janë dërguar 1470 “Njoftime Detyrimi” për debitorët
3. Hapur 949 dosje debitorësh ku janë gjetur UE dhe janë azhornuar në sistemin e Kreditit
4. Janë ndjekur 80 seanca gjyqësore
5. Janë përgatitur 17 akte, përfshirë deklarata mbrojtje, rekurse, konkluzione përfundimtare dhe plotësim të metash padie
6. Janë përgatitur 77 informacione për lëndën e caktuar

7. Janë përgatitur 77 shkresa për lirim të barrës hipotekore dhe pushim veprimesh përmbartimore
8. Janë kryer 66 shërbime në terren për verifikim dhe mbledhje informacioni mbi debitorët

Sipas vlerësimit nga sektori fokusi i punës së AMGKP duhet të jetë identifikimi i debitorëve dhe kontaktimi i tyre. Në këtë mënyrë do të krijohet një e dhënë e saktë mbi gjendjen ekonomiko-sociale të tij duke nxjerrë edhe pritshmëritë e kthimit të detyrimit.

Vlerësimi i punës së stafit nuk mund të jetë më vetëm nëpërmjet arkëtimit, por edhe puna për analizën reale të borxhit të mbetur si dhe trajtimi ligjor, deri në vjeljen e plote të detyrimit.

• **Spektori i Ndjekjes së Proçedurave të Ekzekutimit Përmbarimorë**

Gjatë vitit 2025, veprimtaria e Sektorit të Ndjekjes së Proçedurave të Ekzekutimit Përmbarimor pranë Agjencisë së Menaxhimit të Garancive dhe Kredive të Pakthyer, është fokusuar në rritjen e efikasitetit në kryerjen e detyrave të saj, përmirësimin e monitorimit të dosjeve/debitorëve të ndryshëm si edhe bashkëpunimi me zyrtarë përmbarimorë shtetërorë/private apo edhe institucione të tjera publike për realizimin në kohë të punës së kërkuar në Institucion.

Gjithashtu ka punuar bazuar kryesisht në objektivat si më poshtë vijon:

1. Verifikimi i dosjeve për gjetjen e Urdhërave të Ekzekutimit Original me qëllim vënien në ekzekutim të tyre,
2. Krijimi i marrëdhënieve më të ngushta me Zyrtarë Përmbarimorë Shtetërorë dhe Private, me qëllim arritjen e objektivave dhe ndjekjen e proçedurave brenda afateve të përcaktuara për çdo dosje.

Gjatë vitit 2025, Sektori i Ndjekjes së Proçedurave të Ekzekutimit Përmbarimor ka realizuar detyrat kryesore të përmbledhura si më poshtë vijon:

- Janë dërguar 116 raste të Urdhërave të Ekzekutimit Original për ekzekutim pranë Zyrtarë Përmbarimorë Private dhe Shtetërorë,
- Janë kryer 148 Urdhër Pagesa për shpenzimet përmbarimorë si edhe pagesa për Zyrtarë Përmbarimorë në lidhje me tarifat përmbarimorë fikse sipas kontratave të shërbimit,
- Janë përgatitur 134 shkresa me informacione drejtuar Zyrtarë Përmbarimorë, si kthim përgjigje apo si kërkesë për veprim lidhur me debitorët apo dosjet specifike.
- Janë përgatitur 75 Informacione drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm mbi shkresat hyrëse në Institucion për veprim të mëtejshëm nga ana e sektorit.
- Sektori ka mbajtur dhe ndjekur evidencën e fazave të trajtimit ligjor për të gjithë debitorët, duke e pasqyruar këtë informacion në file-t dhe programet e zgjedhura për

raportim; ku është kryer azhurnimi dhe punimi i 1354 shkresave të ardhura nga Zyrat Përmbarimore.

- Është kryer kontrolli dhe punimi i 566 dosjeve për debitorë në zona të ndryshme të Shqipërisë,
- Janë zhvilluar takime me Zyrat Përmbarimore Shtetërore si vijon: Fier, Kurbin, Mat, Dibër, Elbasan dhe Pukë.

Gjatë gjithë vitit sektori ka mbajtur dhe ka ndjekur evidencën operative të fazave të trajtimit ligjor për të gjithë debitorët, duke e pasqyruar këtë informacion në filelet dhe programet e zgjedhura për raportim.

• **Sektori i Verifikimit të Kërkesave të Garancisë dhe Konfirmimit të Kontratave**

Sipas raportimit nga Sektori i Verifikimit të Kërkesave të Garancisë dhe Konfirmimit të Kontratave gjatë 12 mujorit të vitit 2025 ka patur në fokus:

Objektivat:

1. Verifikimi i kushteve dhe kriterëve të huamarrjes së institucioneve financiare në zbatim të skemave të veçanta të garancive, të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe të emetuara nga Ministria përgjegjëse për financat.
2. Trajtimi dhe shqyrtimi rast pas rasti i kërkesave të huadhënësve mbi thirrjen e Garancisë, sipas skemave të veçanta të saj, duke verifikuar plotësimin e kushteve për thirrjen e Garancisë, sipas legjislacionit në fuqi. Aktualisht po trajtohen rastet e Garancise Sovrane Nr.1 dhe Nr.2 dhe sipas rastit janë kryer pagesat e garancive gjate vitit 2025 .
3. Konfirmimi i draftit të marrëveshjes së huasë, si dhe verifikimin e përmbushjes së kërkesave të marrëveshjeve të garancisë në tipat e kontratave bankare dhe konfirmimin e këtyre kontratave tip brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga paraqitja e kërkesës nga institucioni financiar përkatesisht per Garancinë Sovrane nr.5.
4. Mbajtja në mbikqyerje e rasteve të Garancisë Sovrane Nr.4.
5. Ndjekja dhe trajtimi i marrëveshjeve të nënhuave, huave buxhetore dhe kredive të garantuara, si dhe rakordimi me Ministrinë e Finacave mbi pagesat e kryera dhe shumën e detyrimeve të mbetura, brenda datës 15 të çdo muaji, në formë elektronike.

Detyrat e realizuara dhe arritjet gjatë vitit 2025

1. Janë trajtuar rastet për të cilat është kryer pagesa e garancisë nga Ministria e Financave me miratimin e Agjencisë dhe është kërkuar informacion shkresërisht Bankave lidhur me veprimet e kryera për rekuperimin e detyrimit.
2. Janë trajtuar dhe ndjekur marrëveshjet e nënhuave dhe huave buxhetore të marrë në dorëzim nga Ministria e Financave, ku janë dërguar “Njoftim për shlyerje detyrimi”ne dy periudha perkatesisht në muajin Prill 2025 dhe në muajin Shtator 2025 të gjithë

subjekteve huamarrës për të cilët është kryer pagesa e garancisë nga Ministria e Financave, duke i bërë me dije mbi dispozitat ligjore, si dhe brenda datës 15 të çdo muaji është rakorduar me Ministrinë e Financave mbi pagesat e kryera nga subjektet dhe detyrimin e mbetur, në përputhje me Udhëzimin nr. 21087 datë 16.11.2023 të Ministrit të Financave.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025 janë mbledhur dhe derdhur në buxhetin e shtetit, totali i detyrimeve si më poshtë:

Për nënhuatë dhe huatë buxhetore:

- Total 36,060,804.25 EUR
- Total 524,141.21 SDR
- Total 467,250,442.6 ALL
- Total 144,931,375.51 AED
- Total 5,305,488.52 USD

Për kreditë e garantuara:

- Total 1,538,915.62 EUR

3. Janë kryer takime me subjektet kredimarrës si KESH, OSHEE, OST, Bashkia Tiranë, UKT, në të cilat është diskutuar mundësia e shlyerjes së detyrimeve ndaj Ministrisë së Financave.
4. Është ndjekur ecuria e skemës së Garancisë Sovrane Nr. 4, në të cilën kanë aplikuar 8 subjekte, për të cilat është shqyrtuar gjithë dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Bankat. Gjithashtu, Agjencia ka komunikuar dhe është siguruar që të gjitha Bankat e Nivelit të Dytë, të cilat kanë nënshkruar Marrëveshjen e Garancisë të paguajnë tarifën e disbursimit brenda muajit Shkurt 2025, sipas dispozitave ligjore të Marrëveshjes.
5. Është rikuperuar shuma prej 197,984.45 lekësh në buxhetin e shtetit për subjektin “Beni” shpk, për të cilin është paguar garancia.
6. Është zhvilluar takim me subjektin “Diamond Society” shpk, ku pas diskutimit është rënë dakort që të paguajë çdo muaj një shumë të caktuar të detyrimit ndaj Ministrisë së Financave, duke qenë se është paguar garancia.
7. Është kërkuar informacion për procedurat e ndjekura për rikuperimin e detyrimeve të subjekteve Beni shpk, Aler Travel, Shoesery shpk, Favi color, Diamond society dhe Siguria shpk.
8. Janë bërë propozime në mbështetje të sektorit të bujqësisë me Garanci Shtetërore.
9. Është rikuperuar shuma prej 5,500,000.00 lekësh në buxhetin e shtetit për subjektin “Diamond Society” shpk, për të cilin është paguar garancia.
10. Është rikuperuar shuma prej 485,241.00 ALL në buxhetin e shtetit për subjektin “Siguria” shpk për të cilin është paguar garancia.

11. Sipas miratimit të Garancisë Sovrane nr.5 me Vendimi të Këshillit të Ministave nr. 463, datë 31.07.2025, "Për miratimin e skemës së veçantë të Garancisë Shtetërore të huasë për garantimin e huamarrjes së subjekteve në sektorin e bujqësisë "si dhe Marrëveshjes se Garancisë nr.10959/3 prot., datë 01.08.2025 së nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Financave dhe 11 Bankave të nivelit të dytë, Agjensia ka vijuar ndjekjen e rasteve në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar.
12. Janë shqyrtuar 47 raste sipas kritereve të Marrëveshjes se Garancise Sovrane Nr. 5 ku janë lidhur 42 kontrata huaje me bankat.
13. Janë zhvilluar takime fizike me Ujesjelles Kanalizime mbi kontratat e huave të nënshkruara me Ministrinë e Financave ku është diskutuar mbi problematikat e hasura në lidhje me mospagesat si dhe mënyren e planeve të shlyerjeve.
14. Janë dërguar kërkesa për informacion mbi gjendjen e llogarive bankare me qëllimin verifikimin e aftësisë pagueuse të huamarrësve bankave të nivelit të dytë për subjektet Kesh dhe UKT.
15. Janë trajtuar dhe ndjekur 9 raste të thirrjes së garancisë nga Bankat e Nivelit të Dytë, prej të cilave, pas verifikimit të përmbushjes së kushteve sipas Marrëveshjes së Garancisë, është kryer pagesa nga Ministria e Financave në favor të Bankave përkatëse për 6 subjekte.
16. Janë trajtuar 6 raste për të cilat është kryer pagesa nga Ministria e Financave dhe vazhdimisht është kërkuar informacion Bankave lidhur me veprimet e kryera për rekuperimin e detyrimit.

● **Sektori i Informacionit dhe Administrimit të Dokumentacionit**

Sipas raportimit nga Sektori i Informacionit dhe Administrimit të Dokumentacionit gjatë 12 mujorit të vitit 2025 ka patur në fokus:

Objektivat:

1. Administrimin e dokumentacionit të skemave të veçanta të garancive shtetërore, arkivimin dhe përditësimin e të dhënave të garancive.
2. Kontrollon inventarin dhe gjendjen fizike të pronave në pronësi të Agjencisë.
3. Ndjek çdo procedurë që ka lidhje me ankandet.
4. Raportimin periodik në Bankën e Shqipërisë mbi debitorët e mbyllur.
5. Përgatit dosje të veçantë për çdo objekt të marrë në pronësi nga AMGKP dhe ndjek me përgjegjësi të gjitha procedurat për dokumentimin, administrimin dhe shitjen në ankand të këtyre pasurive sipas përcaktimeve në Ligjin e AMGKP-së dhe akteve nënligjore në fuqi.

Treguesit e performancës:

1. Gjatë vitit 2025 janë administruar në mënyrë elektronike (server) dhe në dosje fizike në arkiv të dhënat e garancisë sovrane GS5.
2. Janë azhurnuar të gjitha shkresat dalëse të institucionit në server.
3. Janë kryer 36 aplikime në ASHK, 4 plan rievimi.

4. Janë raportuar mbyllje në Bankë e Shqipërisë 34 debitorë.
5. Është inspektuar 1 pronë, problematike mbetet aktet nënligjore për inspektimin dhe nxjerrjen në ankand.

Puna e realizuar sipas objektivave përkatëse:

- Administrimi i dosjeve të skemave të garancive, realizuar 100%.
- Raportimi në Bankën e Shqipërisë, realizuar 100%.
- Aplikime në ASHK dhe nxjerrje e dokumentacionit të kërkuar 33%
- Ankandet, realizuar 0%.

• **Sektori i monitorimit dhe mbikëqyrjes së skemave të vecanta të garancisë**

Sipas raportimit nga Sektori i monitorimit dhe mbikëqyrjes së skemave të vecanta të garancisë gjatë 12 mujorit të vitit 2025 ka patur në fokus:

1. Përpunuar informacionin e ardhur nga bankat e nivelit të dytë lidhur me Garancitë Sovrane 1,2,3,4 dhe 5.
2. Përgatitur brenda afateve raporti i garancive çdo muaj për Ministrinë e Financave.
3. Analizuar statement dhe dokumentacioni ekonomiko-ligjor në bashkepunim me sektorin e Verifikimit dhe Konfirmimit të Kontratave për 8 subjekte, për të cilat është thirrur Garancia, në mënyrë që të vërtetohet që e gjithë shuma e disbursuar është përdorur për qëllimin e garancisë sipas marrëveshjeve përkatëse, si nëse ka mangësi në dokumentacion. 6 verifikimet e subjekteve kanë rezultuar të rregullt dhe me pagesë të garancisë nga MF dhe 2 subjekte priten plotësimi i dokumentacionit nga banka pasi nuk është vërtetuar akoma përdorimi i fondeve sipas marrëveshjes.
4. Përgatitur brenda afatit parashikimi i flukseve të principalit për buletin për 3 mujor (Janar-Mars 2025), 6 mujor (Janar- Qershor 2025) dhe 3 mujori i tretë (Korrik-Shtator 2025) deri për vitin 2032 dhe dërguar Ministrisë.
5. Përgatitur informacion Ministrisë sa herë është kërkuar lidhur me principalet që plotësojnë kushtin për pagesë.
6. Rakorduar çdo muaj me Ministrinë e Financave për pagesat e kryera të garancinë për subjektet.
7. Rakorduar me Ministrinë e Financave çdo muaj për pagesat e kthyera mbrapsht nga subjektet të cilëve u kemi paguar garancinë
8. Rakorduar çdo muaj me Ministrinë e Financave për detyrimin e mbetur të subjekteve ndaj Ministrisë së Financave.

7. Rakorduar me Ministrinë e Financave çdo muaj për pagesat e kthyera mbrapsht nga subjektet të cilëve u kemi paguar garancinë

8. Rakorduar çdo muaj me Ministrinë e Financave për detyrimin e mbetur të subjekteve ndaj Ministrisë së Financave.

9. Bashkëpunuar me Ministrinë e Financave për përgatitjen e draft VKM për Garancinë Sovrane 5 (lidhur me nenet të cilat i ndikojnë institucionit tonë).

10. Shqyrtuar të gjitha aplikimet e ardhura për Garancinë Sovrane 5 ku në total janë 47 aplikime nga të cilat 42 janë finalizuar me lidhje kontrate dhe 4 janë tërhequr nga aplikimi.

11. Kemi krijuar databazën me të dhënat sipas bankave për skedulet e kredive për 40 subjekte të cilat janë disbursuar.

Objektivat e Sektorit të Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Skemave të Veçanta të Garancisë:

1. Kryen mbikëqyrjen e kushteve financiare të të gjithë huamarrësve, që kanë marrë garanci nga skemat që ajo menaxhon dhe u kërkon huamarrësve informacionin e nevojshëm për realizimin e kësaj mbikëqyrje,
2. Mban, menaxhon dhe përditëson bazën e të dhënave dhe regjistrin analitik të garancive që menaxhon,
3. Verifikimin e aftësisë paguese të subjekteve huamarrëse për të cilat është kryer pagesa e garancisë në secilën prej skemave të garancive të miratuara, huave dhe nënhuave, të garantuara nga Ministri përgjegjës për financat,
4. Shqyrton dhe analizon raportet periodike të çdo huadhënësi për huatë e aprovuara prej tij dhe çdo informacion dhe dokument tjetër të nevojshëm për monitorimin e ecurisë së garancisë.
5. Verifikimi i dosjeve ekonomiko-ligjore për çdo subjekt për të cilin do të na vijë kërkesa për pagesë.
6. Raportimi sipas afateve për çdo raport mujor lidhur me Garancitë Sovrane që dërgojmë në Ministrinë e Financave

Treguesit e performancës:

1. Sektori çdo muaj merr raportet nga bankat e nivelit të dytë të cilat janë pjesë e Skemave të Garancive Sovrane 1,2,3,4 dhe 5. Pas marrjes së raporteve përpunon të dhënat dhe konfirmon bankën për saktësinë ose jo të raportit;
2. Evidenton çdo muaj totalin e principaleve të cilat janë të vonuara në pagesë nga subjektet sipas skemave dhe sipas marrëveshjeve të lidhura;
3. Evidenton principalet e vonuara të cilat e kanë plotësuar kushtin për tu paguar garancia për secilën bankë;
4. Verifikohen disbursimet për çdo subjekt nëse nuk kanë kaluar limitin sipas kontratës së kryer;

5. Verifikohen dhe monitorohen overdraftet nëse stoku nuk ka kaluar disbursimin sipas kushteve të kontratës së lidhur;
6. Përpunohen të dhënat për nxjerrjen e stokut, principalit të paguar dhe principalit progresiv;
7. Përpunohet çdo skedulim kredie i ardhur nga banka lidhur me pagesat e subjekteve;
8. Monitorohen bankat dhe verifikohet çdo raport lidhur me pagesat e kryera për Garancinë nga Ministria e Financave si dhe përlllogaritja e tyre si pagesë për subjektin;
9. Evidentohen dhe verifikohen të gjitha kreditë apo overdraftet të cilat janë raportuar nga banka si të mbyllura.
10. Përgatiten raporte 3,6,9 dhe 1 vjeçare për Ministrinë dhe parashikohet çdo 3 muaj fluksi i principaleve deri në 2032 dhe gjithashtu parashikimi i stokut për kuadrin makro një ose dy herë në vit deri në vitin 2032 (sipas kërkesës së Ministrisë së financave).
11. Përpunohet dhe përgatitet çdo lloj raportimi që kërkohet nga Ministria e Financave sipas nevojës.

Për 2025:

GS1 - është mbyllur 1 kontratë
GS2 - 216 kontrata të mbyllura
GS3 - 3 kontrata të mbyllura

Totali 220 kontrata të mbyllura në vitin 2025.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

